



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.244/5 prot

Datë 09.02.2026

V E N D I M
Nr. 214/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.02.2026, shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Mall”, me REF-74312-01-22-2026 me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi për nevojat e shoqërisë”. – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj”, me fond limit 2 350 155 (Dy milion e treqind e pesëdhjet mijë e njëqind e pesëdhjet e pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 06.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujësjelles Kanalizime Lushnje Sh.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6., Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqeria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh.A. Lagja “18 Tetori” Lushnje
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 24 e vijues, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe

Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.01.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Mall”, me REF-74312-01-22-2026 me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi për nevojat e shoqërisë”. – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj”, me fond limit 2 350 155 (Dy milion e treqind e pesëdhjet mijë e njëqind e pesëdhjet e pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 06.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujësjelles Kanalizime Lushnje Sh.A.

II.2. Në datën 27.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6281 dhe

me nr. 244 prot., datë 27.01.2026 e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me anë të së cilës ka kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë:

Ne si Operator Ekonomik me date 23.01.2026 morem dijeni nepermjet sistemit elektronik hedhjen e procedures me objekt Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi për nevojat e shoqërisë – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj. Duke qe se kerkesat ne DST bien ndeshjen me Ligjiin e Prokurimit Publik, po paraqisim ankesen tone ne lidhje me kriteret e vendosura nga AK .

Si fillim përpara se të paraqesim argumentimin për heqjen e këtij kriteri kërkojme tju sqarojmë për përdorimin e produkteve objekt prokurimi “Hipoklorit Natriumi” dhe “Hipoklorit Kalciumi”. Të dyja këto mallra objekt prokurimi shpërbejnë për dezinfektimin e ujit, dhe të dyja këto produkte janë njësoj të rëndësishme, ndryshimi është sepse njëri është likuid (Klor lëng) dhe tjetri pluhur (Klor Pluhur). Rëndësia është njëlloj për të dyja produktet dhe asnjëri nuk qëndron më lart dhe më poshtë por janë dyja produkte të barabarta për nga rëndësia dhe nga fusha e përdorimit.

AK ka kërkuar:

2.4.3. Me qëllim vërtetimin se produkti objekt prokurimi “Hipoklorit Natriumi”, është prodhuar nga prodhues të licencuar, dhe se është në përputhje me specifikimet teknike e standartet e kërkuara, Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

1. Në rast se ofertuesi është vetë prodhues, duhet të paraqesë:

- Çertifikatën që vërteton konformitetin e produktit me standardin SSH EN 901: 2013 “Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor” - Leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për kimikatin e kërkuar

2. Në rast se ofertuesi nuk është vetë prodhues, duhet të paraqesë: - Autorizim të prodhuesit për ofertuesin ose autorizim për ofertuesin nga distributori i autorizuar prej prodhuesit ose që ka lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi me prodhuesin (ose ekuivalenti i tij/saj) sipas ligjit. Gjithë këto dokumente duhet të kenë afat vlefshmërie për gjithë kohëzgjatjen e kontratës të kësaj procedure prokurimi, i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Ku në rast se autorizimi është lëshuar nga distributori duhet të paraqitet edhe Autorizimi/ Marrëveshja e bashkëpunimit midis distributorit dhe prodhuesit, e cila duhet të jetë e vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit.

- Çertifikatën e origjinës, cilësisë dhe Skedë teknike të lëshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produktit të prodhuar me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

- Lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Licensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojin e kimikatit, në rast se ofertuesi është vetë importues, dhe në rast se nuk është vetë importues, duhet

të paraqesë kontratën e furnizimit me një importues të këtij malli i cili disponon lejen e importit. Argumentimi jonë:

Ne si Operator Ekonomik bëjmë pjesë të pika 2 e kriterit sipërpërmendur (pra si disitributor

dhe jo prodhues)

Autoriteti Kontraktor në kriterin 2.4.3 ka cituar rëndësinë e produktit “Hipoklorit Natriumi” duke kërkuar

1 – Certifikatën e konformitetit

2- Autorizimin e prodhuesit

3- Certifikatën e origjinës

4- Lejen e importit.

Ndërsa në argumentimin e këtij kriteri ka cituar se:

Të nderuar anëtarë të komisionit të prokurimit, të dy mallrat objekt prokurimi janë të rëndësishëm pasi do të kryejnë të njëjtin funksion dhe shërbejnë për trajtimin e ujit të pijshëm. Për këtë arsye ne nuk e kuptojmë se përse AK i ka dhënë rëndësi vetëm njërit produkt “Hipoklorit Natriumi” duke kërkuar dokumentacion vetëm për këtë produkt?

Duke qënë se AK është autoriteti që vendos kriteret dhe bara e provës i përket këtij autoriteti kërkojmë një sqarim të argumentuar nga ana shkencore (sepse ju keni specialistët tuaj) pse malli objekt prokurimi “Hipoklorit Natriumi” është shumë i rëndësishëm dhe malli tjetër objekt prokurimi “Hipoklorit Kalciumi” nuk është i rëndësishëm?

Pse të dyja mallrat objekt prokurimi që do të përdoren për të njëjtin qëllim final, përdorimi për dezinfektimin e ujit të pijshëm, dhe nga ky përdorim do të ketë të njëjtin impakt në shëndetin e popullatës, vlerësimi i rëndësisë behët jo njëllor?

Për ne si Operator Ekonomik të dyja këto produkte janë të rëndësishme dhe duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik 162.2020, Neni 1, Neni 2, Neni 20 , kërkojmë modifikimin ose heqjen e kriterit 2.4.3. Pra duke vlerësuar rëndësinë e njëjtë të të dyja produkteve, “Hipoklorit Kalciumi” dhe “Hipoklorit Natriumi”, kërkojmë që të kërkohej i njëjti dokumentacion për të dyja mallrat objekt prokurimi, ose te hiqet ky kriter duke mos dorezuar dokumentacionin edhe për mallin objekt prokurimi “Hipoklorit Natriumi”

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr.66/6 prot., datë 28.01.2026, protokolluar me tonën me nr.244/1 prot., datë 29.01.2026 me objekt “Mbi plotësimin e të metave të anksës”, autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e datës 27.01.2026 me Niptin e ri të autoritetit kontraktor Shoqeria Rajonale Ujësjetles Kanalizime Lushnje Sh.A.

II.5 Nëpërmjet shkresës nr.66/8 prot., datë 03.02.2026, protokolluar me tonën me nr.244/2 prot., datë 05.02.2026 me objekt “Vendim për shqyrtim ankese”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, nga autoriteti kontraktor. Referuar shkresës së mësipërme, rezulton, se autoriteti kontraktor

ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur pranim të plotë të saj duke lëmnë në fuqi që i njëjti dokumentacion të kërkohet ng autoriteti kontraktor për të dyja zërat e prokurimit publik, konkretisht për “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklit Kalciumi”

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Albania Distribution Chemicals” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës për modifikimin e Kriterit të veçantë të kualifikimit, pika 2.3.4, me argumentimin se *duke vlerësuar rëndësinë e njëjtë të të dyja produkteve, “Hipoklorit Kalciumi” dhe “Hipoklorit Natriumi”, kërkojmë që të kërkohet i njëjti dokumentacion për të dyja mallrat objekt prokurimi, ose te hiqet ky kriter duke mos dorezuar dokumentacionin edhe për mallin objekt prokurimi “Hipoklorit Natriumi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor Shoqeria Rajonale Ujësjelles Kanalizime Lushnje Sh.A. nr.66/8 prot., datë 03.02.2026, protokolluar me tonën me nr.244/2 prot., datë 05.02.2026, rezulton se ankesa është pranuar plotësisht.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se:
1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe

rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
- ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i shkresës nr.66/8 prot., datë 03.02.2026, protokolluar me tonën me nr.244/2 prot., datë 05.02.2026, të dorëzuar pranë KPP-së, nga autoriteti kontraktor, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim plotësisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime, për sa kohë ato janë pranuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik *“Albania Distribution Chemicals” SHPK* në procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur e thjeshtuar, Mall”*, me REF-74312-01-22-2026 me objekt: *“Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi për nevojat e shoqërisë”*. – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj”, me fond limit 2 350 155 (Dy milion e treqind e pesëdhjet mijë e njëqind e pesëdhjet e pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 06.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujësjelles Kanalizime Lushnje Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik *“Albania Distribution Chemicals” SHPK*.

5. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

